



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA ADMINISTRATIVE E APELIT TIRANË

Nr. 9171/4542/2249 Regj. Themeltar
Datë 10.11.2014 e Regjistrimit

Nr. 3617 vendimi
Datë 03.11.2016 e vendimit

V E N D I M
“NË EMËR TË REPUBLIKËS”

Gjykata Administrative e Apelit Tiranë, e përbërë nga gjyqtarët :

KRYESUESE : FJORALBA PRIFTI
ANËTAR: ARTUR MALAJ
ANËTARE: BLERONA HASA

Asistuar nga sekretare gjyqësore **Anjeza Bardulla** sot, në Tiranë, më datë 03.11.2016, shqyrtoi në dhomë këshillimi çështjen administrative me nr. 9171/4542/2249 regjistri themeltar, datë 10.11.2014 regjistri që i përket palëve:

PADITËSE:

Shoqëria Anonime “Ujësjellësi” sh.a Kurbin.

TË PADITURA:

Drejtoria Rajonale e Tatimeve (DRT) Lezhë.
Drejtoria e Apelimit Tatimor (DAT) pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve Tiranë.

OBJEKTI:

1. Shfuqizimin e aktit administrativ të Raport Kontrollit Përfundimtar të datës 13.02.2013 të Drejtorisë Rajonale Tatimore Lezhë, për shumën e detyrimeve tatimore.
2. Shfuqizimin e aktit administrativ të vendimit Nr. 4767/2 prot, datë 03.05.2013 të Drejtorisë së Apelimit Tatimor, pranë D.P.T. Tiranë.

BAZA LIGJORE:

- Nenet 32, 46, 153, 154, 154/a, 156 i K.Pr.Civile.
Nenet 105 e vijues të K.Pr. Administrative.
Ligji Nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore” nenet 109, 110.
Ligji Nr. 8438, datë 28.12.1998 me ndryshimet “Për Tatimin mbi të ardhurat”.
Ligji Nr. 7928, datë 27.04.1995 “Për TVSH-në”.
Ligji Nr. 9228, datë 29.04.2004 “Për Kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”.
Udhëzimi i Ministrit të Financave Nr. 24, datë 02.09.2008.

Ligji Nr.49/2012 "Për Organizimin dhe Funksionimin e Gjykatave Administrative dhe Gjykimin e Mosmarrëveshjeve Administrative".

Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Shkodër me vendimin Nr. 436, datë 14.05.2014, ka vendosur:

- *Mos pranimin e padisë.*
- *Shpenzimet gjyqësore siç janë bërë.*
- *Kundër vendimit lejohet ankim i veçantë brenda 5 ditëve nga e nesërmja e shpalljes pranë Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë. Për palën paditëse Shoqëria Anonime "Ujësjellësi" Kurbin(në mungesë). Ky afat fillon nga dita e njofimit të vendimit.*

Kundër vendimit Nr. 436, datë 14.05.2014 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë ka paraqitur ankim pala paditëse shoqëria anonime "Ujësjellësi" sh.a, Kurbin me të cilin ka kërkuar:

Ndryshimin e vendimit Nr. 436, datë 14.05.2014 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë si të pambështetur në ligj dhe në prova si dhe pranimin e plotë të kërkesë padisë, duke parashtruar këto shkaqe:

- Ankuesja në ankimin e saj parashtron se vendimi i gjykatës së shkallës së parë është dhënë në kundërshtim të plotë me ligjin, duke keqinterpretuar kërkimin e objektit të padisë, duke mos bërë asnje hetim për çështjen dhe duke mos marrë në konsideratë që barrën e provës në rastin konkret për të provuar të kundërtën e ka pala e paditur.
- Shoqëria Anonime "Ujësjellësi" Kurbin, me numër NIPT K 07628310 A ushtron aktivitet për prodhimin dhe shitjen e ujit të pijshëm. Ajo ka qenë subjekt kontrolli nga Drejtoria Rajonale Tatimore Lezhe për periudhën 2009-2012 dhe sipas raportit nr. 03/03 prot, datë 13.02.2013, shoqëria ka detyrime tatimore jashtë sistemit informatik në shumën prej 957.858 lekë dhe interesa në shumën 316.239 leke, detyrimi është gjithsej 1.307.162 lekë.
- Mbi bazën e këtij raport kontrolli, D.R.T Lezhë ka nxjerrë njofim vlerësimin tatimor nr. 03/04, datë 06.03.2013, me detyrimet e sipërcituara.
Subjekti ka kryer apelim në Drejtorinë e Apelimit, pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, Tiranë, e cila me vendimin e datës 03.05.2013, ka vendosur refuzimin e ankimit, për shkak se e konsideron ankimin të pa pranueshëm, pasi nuk janë plotësuar kërkesat e nenit 106.2.4 germa (dh) të ligjit Nr. 9920, datë 19.05.2008, "Për Procedurat Tatimore në R.Sh".
- Ankuesja parashtron se brenda afatit ligjor 30 ditor i është drejtuar me kërkesëpadi Gjykata Administrative së Rrethit Gjyqësor Lezhë si gjykatë kompetente, në bazë të dispozitave ligjore të cituara në kërkesë-padi, për shkak se nuk ka qenë dakord me vendimet e nxjerra nga palët e paditura.
- Pas ndryshimeve të ligjit për gjykatën administrative Gjykata e Rrethit Gjyqësor Lezhë ka shpallur moskompetencën dhe ka kaluar aktet gjykatës kompetente konkretisht Gjykata Administrative të Shkallës së Parë Shkodër.
- Shoqëria parashtron se i ka paraqitur kërkesë Drejtorisë Rajonale Tatimore Lezhë të datës 02.05.2013 për sistemin e TVSH, pasi sipas librave të shitjes nga zbulimi i auditimit të shoqërisë, rezulton të ketë T.V.SH kreditore në shumën prej 1.307.262 lekë.

- Në bazë të ligjit Nr. 9920, datë 19.05.2008 "Për Procedurat Tatimore", dhe Udhëzimit të Ministrit të Financave Nr. 24, datë 02.09.2008 është kërkuar kompensim i këtyre detyrimeve për Tatim Fitimin e vitit 2010 me T.V.SH-në Kreditore të vitit 2012 deri në muajin shkurt të vitit 2013.
- Shoqëria parashtron se këtë kompensim e ka kërkuar përfekt, të kryerjes së parapagimit të detyrimeve tatimore, të cilat janë ankimuar pranë DAT-së, në kushtet e ankimimit të detyrimeve të përcaktuara në njoftim detyrimin nr. 03/04, datë 06.03.2013, vlerësuar nga DRT Lezhë. Ankuesja parashtron se njohja e tepricës kreditore është kërkuar në kushte e pamundësisë financiare përfundimisht që ankimohet.
- Ankuesja parashtron se në apelimin e kryer pranë Drejtorisë së Apelimit Tatimor është kërkuar anulimin i pjesshëm i njoftim vlerësimit dhe raport kontrollit në lidhje me analizimin e të ardhurave dhe shpenzimeve përfundimtar 2009-2012, sepse ishin bërë disa gabime teknike pasi nuk ishte llogaritur kompensimi i detyrimeve tatimore të T.V.SH-së kreditore në shumën prej 1.307.162.
- Ankuesja parashtron se në raport kontroll janë kryer gabime, të cilat nuk kanë përcaktuar saktë uljen e T.V.SH-së. Ndërsa përfundimtar 2010 rezulton të janë rritur padrejtësisht të ardhurat në shumën 17.763.600 lekë, fakt ky i cili është analizuar në bilancin e vitit 2010, por që nuk është marrë parasysh gjatë kontrollit. Subjekti parashtron se ky ka qenë një shpenzim në pritje përfundimtar 2009 sepse nga rakordimi i kryer me shoqërinë CEZ ka rezultuar se disa fatura ishin prerë me vlerë më të madhe se shpenzimet faktike. Në vitin 2010 kjo llogari u mbyll direkt me llogarinë e furnitorit. Përfundimisht këto arsyesh rivlerësimi i të ardhurave nuk qëndron e përfundimtar 2012 është kërkuar anulimi i fitimit të gjobës.
- Subjekti kundërshton masën e gjobës të përcaktuar në muajin nëntor 2012, përfundimtar 115 236 lekë në zërin T.V.SH, përfundimtar se nuk ka pasur shitje të pa faturuara dhe TVSH e llogaritur është fiktive, pasi subjekti disponon të gjitha dokumentet ligjore të blerjes dhe shitjes. Arsyetimi i përdorur nga organet tatimore se shteti e ka paguar një herë T.V.SH-në nëpërmjet subvencionit nuk ka bazë ligjore.
- Në këto rrethana është kërkuar anulimi i vendimit nr. 4746/2 prot, datë 03.05.2013 të Drejtorisë së Apelimit Tatimor pranë D.P.T Tiranë.
- Subjekti parashtron se në bazë të auditimit ligjor të pasqyrave financiare të vitit 2012 të palës paditëse u konstatua se nuk përpunohet shpenzimet e bilancit me shpenzimet e deklaruara në F.D.P. Pas verifikimit të dokumenteve rezulton se nga shoqëria nuk është bërë deklarimi i faturave të blerjes si ato të përjashtuara po ashtu me blerjet me T.V.SH. Të gjitha këto ndryshime të periudhës janar – dhjetor 2011-2012 janë të saktësuarë në shkresën nr. 79 prot, datë 02.05.2013 të palës paditëse drejtuar D.R.T Lezhë.
- Shoqëria në ankimin e saj i është referuar raportit të ekspertimit, i cili është hartuar nga eksperti në bazë të të cilit janë bërë analizat e të ardhurave dhe shpenzimeve përfundimtar 2008-2012. Ajo parashtron se është zbritur padrejtësisht shuma prej 23.304.564 lekë si TVSH e zbritshme, pasi janë rivlerësuar padrejtësisht të ardhurat nga shitjet e vitit 2012, në shumën prej 117.099.013 lekë. Ankuesja parashtron se rivlerësimi i kryer nga tatimet është në masën 157.149.568 lekë ndërkohë që shitjet reale janë 40.050.555 lekë, të pasqyruara sipas bilancit. Si rrjedhojë e kësaj rillogaritje janë krijuar detyrime TVSH, tatim fitimi e gjoba të tjera.
- Shoqëria parashtron se ky rivlerësim i nxjerrë nga pala e paditur është absolutisht i paligjshëm përfundimtar se ajo shet ujë nën kosto dhe përfundimtar 2012 është arsyesh shteti subvencionon

diferencën e çmimit. Të gjitha veprimet janë kryer rregullisht dhe figurojnë me TVSH kreditore. Inspektorja e organit tatimor kreu kontrollin dhe një njëkohësisht ka konstatuar faktin se uji shitet me humbje, pasi të drejtën e vendosjes së çmimit e ka Enti Rregullator i Ujit. Pavarësisht këtij fakti, ajo ka kryer veprime jashtë kompetencës së saj.

- Subjekti parashtron se veprimet e kryera nga inspektorët e DRT Lezhë janë në shkelje të përcaktimave të ligjit Nr. 9920, datë 19.05.2008 "Për procedurat tativore". DRT Lezhë ka penalizuar padrejtësisht subjektin në shumën prej 27.213.235 lekë në total. Është zbritur padrejtësisht tatim fitimi i viti 2010 për shumën prej 957.585 lekë dhe gjobë 239.396 lekë. Gjobë TVSH-je për periudhën 11/2013 në shumën 115.2365 lekë.
- Gjithashtu nuk është e drejtë ulja e TVSH-së në shumën 23.304.564 lekë, pasi këto konkluzione janë nxjerrë edhe nga eksperti shoqërisë, i cili ka vlerësuar se janë rritur padrejtësisht të ardhurat në shumën prej 17.763.600 lekë. Kjo shumë ka qenë shpenzime në pritje gjatë viti 2009 sepse nga rakordimi i OSSH-së rezultonte se faturat e energjisë elektrike ishin më të mëdha se fakti.
- Në vitin 2010 kjo llogari është mbyllur direkt me llogarinë e furnitorit dhe për këtë arsy rivlerësimi i të ardhurave nuk qëndron e për pasojë kërkohet anulimi i tatim fitimit dhe gjobës.
- Nuk qëndron gjoba e muajit nëntor 2012 për shumën prej 115.236 lekë gjobë TVSH sepse nuk ka pasur shitje të pa faturuara dhe për këtë arsy është kërkuar anulimi i pjesshëm i njoftim vlerësimit nr. 03/4, datë 06.03.2013 për tre shumat e mësipërme gjithsej në vlerën totale 24.616.781 lekë.
- Shoqëria paditëse parashtron se pretendimi i gjykatës në pjesën arsyetuese të saj se pala paditëse ka kundërshtuar raport kontrollin dhe jo reportin e vlerësimit nuk qëndron për faktin se raporti i vlerësimit është rezultat i Raport Kontrollit Përfundimtar të nxjerrë nga pala e paditur DRT Lezhë.
- Shoqëria parashtron se ajo ka ezauruar rrugën e ankimit administrativ, kërkesë-padia është ngritur brenda afatit ligjor siç e parashikon ligji, kërkesë-padia është e bazuar në prova dhe në ligj dhe si e tillë duhet të pranohet nga gjykata.

Me vendimin e datë 18.8.2014 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Shkodër është vendosur plotësimi i të metave të ankimit të paraqitur nga paditësja për mospagim tarife.

Me vendimin e datës 29.09.2014 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Shkodër është vendosur pranimi i ankimit të palës paditëse.

GJYKATA ADMINISTRATIVE E APELIT

Pasi u njoh me relacionin e gjyqtarës Fjoralba Prifti, u njoh me ankimin e palës paditëse shoqëria anonime "Ujësjellësi" sh.a, Kurbin me të cilin është kërkuar:

Ndryshimi i vendimit Nr. 436, datë 14.05.2014 i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë si i pambështetur në ligj dhe në prova si dhe pranimi i kërkesë padisë, si dhe pasi verifikoi kushtet e pranueshmërisë së ankimit.

VËREN

Se Gjykata Administrative e Apelit ka marrë në shqyrtim çështjen mbi ankimin e palës paditëse shoqëria anonime “Ujësjellësi” sh.a, Kurbin e cila kundërshton vendimin objekt ankimi me të cilin është vendosur mospranimi i padisë.

Rrethanat e çështjes.

Nga shqyrtimi akteve të dosjes gjyqësore rezulton se:

1. Paditësja shoqëria “Ujësjellësi”, Kurbin është shoqëri tregtare, e regjistruar në QKR më datë 25.01.2002 me nr. NIPT-i K 07628310 A.

2. Kjo shoqëri ushtron aktivitetin e saj në fushën e shërbimit të furnizimit me ujë të pijshëm i konsumatorëve dhe shitja e tij, mirëmbajtja e sistemit të furnizimit me ujë të pijshëm.

3. Shoqëria rezulton të ketë qenë subjekt i kontrollit të DRT Lezhë për zërat financiarë TVSH 2009/1 deri më 2012/11, tatim fitimit për vitet 2009, 2010, 2011, kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore nga viti 2009/1 deri më 2012/11.

Si rrjedhoje e kryerjes së kontrollit të ushtruar në shoqëri, rezulton se pala e paditur, DRT Lezhë ka vijuar me raportin përfundimtar i cili është komunikuar me shkresën nr. 03/2 prot, datë 14.02.2013.

4. Sipas konkluzioneve që përmban ky akt kontrolli rezultoi të jenë evidentuar detyrime të shoqërisë dhe për këto detyrime shoqëria është bërë me dijeni nëpërmjet njoftimit vlerësimit tatimor Nr. 03/4 prot, datë 06.03.2013.

5. Nga përbajtja e njoftimit detyrimtit ka rezultuar se janë nxjerrë detyrime për vitin 2010, 2011, 2012 kryesisht në zërat TVSH, Tatim Fitim.

Subjekti në kushtet kur nuk ka qenë dakord me konkluzionet e raport kontrollit, të sipërcituar shoqëria ka paraqitur ankimin administrativ në Drejtorinë e Apelimit Tatimor duke kundërshtuar Raportin e Kontrollit.

6. Drejtoria e Apelimit Tatimor pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve nëpërmjet vendimit nr. 4767/2 prot, datë 03.05.2013 ka vendosur: “Refuzimin e ankimit, për shkak se e konsideron ankimin të papranueshëm, pasi nuk janë plotësuar kushtet e nenit 106.2.4 germa dh) të ligjit 9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në RSH”.

Nga përbajtja e këtij vendimi rezulton se para se të jepej vendimi mbi ankimin e kryer, DAT Tiranë pasi ka konstatuar se kërkesa nuk ishte e plotë me kërkesat e ligjit pasi mungonte Akti Administrativ objekt apelimi për të cilën tatimpaguesi pretendonte për detyrimet në zbatim të kërkesave të ligjit 9920/2008 si dhe udhëzimit nr. 24, datë 02.09.2013, subjektit i është kërkuar që të plotësonte kërkesën e apelimit duke paraqitur dokumentacionet e Akt Kontrollit dhe proces verbalet bashkangjitur. Pas kalimit të afatit rezultoi se tatimpaguesi nuk ka kryer plotësimin e dokumentacionit.

7. Paditësja duke mos qenë dakord me vendimin e DAT Tiranë i është drejtuar gjykatës me kërkesë për shfuqizimin e Raport Kontrollit Përfundimtar dhe vendimit të DAT Tiranë.

Procedura gjyqësore dhe vlerësimi i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.

8. Paditësja i është drejtuar me padi Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë më datë 30.05.2013 duke kërkuar:

Shfuqizimin e aktit administrativ të Raport Kontrollit Përfundimtar të datës 13.02.2013 të Drejtorisë Rajonale Tatimore Lezhë, për shumën e detyrimeve Tatimore, shfuqizimin e aktit administrativ të vendimit nr. 4767/2 prot, datë 03.05.2013 të Drejtorisë së Apelimit Tatimor, pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, Tiranë.

9. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Lezhë me vendimin Nr. 19, datë 10.01.2014 ka vendosur shpalljen e moskompetencës lëndore të çështjes administrative me nr. akti 8/697 me paditës shoqëria anonime Ujësjellësi, Kurbin dhe të paditur DRT Tiranë dhe DAT dhe dërgimin e akteve Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Shkodër.

10. Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Shkodër gjatë kryerjes së veprimeve përgatitore në datën 26.03.2014 ka konstatuar se padia paraqet të meta, për këtë arsy e në bazë të nenit 25 të ligjit Nr. 49/2012 ajo ka kërkuar plotësimin e të metave me :

- plotësimin e shkakut ligjor të kërkesë padisë, në përputhje me nenet 16,17, 18 të ligjit 49/2012.
- plotësimin e kritereve të nenit 21 të ligjit 49/2012, numrin e telefonit dhe deklaratën me anë të të cilës pranohet njoftimi me anë të telefonit, listën e personave që kërkon të thirren në gjykim, me cilësinë e ekspertit apo të dëshmitarit, duke përcaktuar saktë edhe adresën e tyre.
- paraqitjen e dy pullave postare për njoftimet e palëve të paditura DPT Tiranë dhe DRT Lezhë.
- paraqitjen e dy kopjeve të kërkesë padisë dhe provave për palët e paditura.

11. Në seancën e datës 08.04.2014 është vendosur që paditëses t'i lihet një afat i dytë për plotësimin e të metave të kërkesë padisë duke e njofuar atë , që brenda datës 17.04.2014, ora 13.00 duhet t'i paraqiste aktet në sekretarinë e gjykatës.

Gjykata ka paralajmëruar palën paditëse se mosplotësimi i të metave të padisë brenda afatit të , pra deri më datë 17.04.2014, shkaktonte kthimin e padisë dhe të akteve, sipas nenit 25/1 të ligjit Nr. 49/2012.

Në veprimet përgatitore të datës 17.04.2014 është konstatuar plotësimi i të metave të padisë dhe është vijuar me veprimet përgatitore të tjera, me komunikimin e padisë palës së paditur etj.

12. Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Shkodër, në seancë përgatitore , me vendimin Nr. 432, datë 14.07.2014 ka vendosur mospranimin e kërkesë padisë, duke arsyetuar se pa shqyrtaur çështjen në themel, ka arritur në përfundimin se pala paditëse, pavarësisht kohës së mjaftueshme akorduar asaj për paraqitjen e provave shkresore, nuk ka provuar me prova shkresore ekzistencën e aktit.

Gjykata ka konstatuar se pala paditëse nuk ka ushtruar të drejtën e ankimit administrative ndaj një akti administrative, që është njoftim vlerësimi tatimor me nr. prot 03/4, datë 06.03. 2013, por ka ushtruar ankrim ndaj raport kontrollit të datës 13.02.2013 e në këto rrethana dhe ankimi administrativ është rrëzuar me vendimin Nr. 4767/2 prot, datë 03.05.2013 të DAT .

13. Në këto kushte gjykata ka vlerësuar ndodhej para kushteve të nenit 39 .2 të ligjit 49/2012, pasi kërkesë padia nuk plotëson kushtin formal të detyrueshëm për t'u shqyrtaur nga Gjykata Administrative, për faktin e vetëm që pala paditëse jo vetëm që nuk është ankimuar ndaj një akti administrative por dhe nuk ka ezauruar rrugën administrative të detyrueshme, konform nenit 106.2.4 germa dh të ligjit Nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore” dhe nenit 16 pikë I të ligjit 49/2012, prandaj nga ana e saj është disponuar me mospranimin e padisë.

Vlerësimi i gjykatës Administrative të Apelit.

14. Gjykata e Apelit pasi u njoh me shkaqet e paraqitura në ankım, provat e marra në shqyrtim dhe arsyetimin e gjykatës së shkallës së parë, arrin në përfundimin se vendimi Nr. 432, datë 14.07.2014 i Gjykatës Administrative të Shkallës së parë Shkodër duhet të lihet në fuqi duke arsyetuar si vijon:

15. Në lidhje me pretendimet e paraqitura në padi për pavlefshmërinë e vendimit të palës së paditur Raport Kontrolli Përfundimtar i datës 13.02.2013 i DRT Lezhë dhe vendimit Nr. 4767/2 prot, datë 03.05.2013 të Drejtorisë së Apelimit Tatimor, pranë D.P.T Tiranë, Gjykata Administrative e Apelit konstaton se paditësi e ka orientuar shqyrtimin gjyqësor në funksion të provueshmërisë së pavlefshmërisë relative të aktit, për shkak se ai është nxjerrë në kundërshtim me provat dhe përcaktimet ligjore.

16. Në lidhje me kërkimet që lidhen me shkaqet e pavlefshmërisë relative të aktit që kundërshtohet, Gjykata Administrative e Apelit vlerëson se paditësi nuk ka shteruar ankimin administrativ sipas Ligjit Nr. 9920, date 19.05.2008 "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë" dhe për pasojë nuk plotësohet një nga kushtet formale të padisë të përcaktuara në nenin 16.1 të ligjit 49/2012 në të cilin përcaktohet se : "*Padia ndaj veprimit administrativ mund të ngrihet vetëm pas shterimit të ankimit administrativ.*"

17.1 Se pala paditëse nuk ka shteruar ankimin administrativ rezulton nga përcaktimet e nenit 107 të ligjit nr. 9920/2008 në të cilin përcaktohet se:

"1. *Tatimpaguesi, i cili kërkon të ankimojë, sipas pikës 1 të nenit 106 të këtij ligji, duhet që, bashkë me ankesën, të paguajë shumën e plotë të detyrimit tatimor, të përcaktuar në njoftimin e vlerësimit të administratës tatimore....*

3. *Ankimi merret në shqyrtim vetëm kur tatimpaguesi ka paguar detyrimin tatimor, që është subjekt i ankimit.*

4. *Akti administrativ, i lëshuar nga administrata tatimore dhe për të cilin nuk është ankimuar në rrugë administrative, nuk mund të ankimohet në rrugë gjyqësore".*

17.2 Nga aktet e marra në shqyrtim nuk rezulton që paditësja të ketë paguar detyrimin tatimor të caktuar në njoftim vlerësimin nr 03/04, datë 06.03.2013, ndërkohë që ajo nuk e ka kundërshtuar këtë akt në DAT, e për pasojë kjo e fundit me vendimin nr. 4767, datë 03.05.2013 ka refuzuar marrjen në shqyrtim të ankimit administrativ, pasi referuar dispozitës së mësipërme, pagesa e detyrimit tatimor të përcaktuar në aktin administrativ për ankimesen përbën kusht për marrjen në shqyrtim të ankimit administrativ.

17.3 Pretendimet e paditëses të paraqitura në ankım se ajo i kishte paraqitur DRT Lezhë kërkësë për kompensimin e detyrimeve tatimore më datë 02.05.2013 dhe se ajo i plotësonte kushtet e kompensimit të detyrimit tatimor, nuk janë të provuara me prova konkrete, pasi paditësja nuk ka provuar para gjykatës se këtë kërkësë ia kishte dorëzuar palës së paditur.

Në këto rrethana, paditësja nuk ka mundur të provojë se pala e paditur kishte vijuar me refuzimin e ankimit, megjithë kërkësën e saj për kompensim të detyrimeve për efekt të ankimit administrativ në DAT ndaj njoftim vlerësimit nr. 03/04, datë 06.03.2013 dhe gjendjes kreditore të saj për të realizuar këtë kompensim.

18. Në këto rrethana, Gjykata Administrative e Apelit arrin në konkluzionin se me të drejtë Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Shkodër ka proceduar me mospranimin e padisë duke qenë se padia e paditëses “ Ujësjellësi Kurbin ” sh.a nuk plotëson kushtet formale të saj duke qenë se nuk kishte shteruar ankimin administrativ ndaj aktit nr. 03/04, datë 06.03.2013 të DRT Lezhë, me të cilin ajo është ngarkuar me detyrime tatimore, si dhe duke qenë se me padi ao kundërshtonte raport kontrollin mbi bazën e të cilit ishte nxjerrë akti nr. 03/04, datë 06.03.2013 të DRT Lezhë dhe jo vetë akti administrativ, në kundërshtim me përcaktimet e neneve 16.1 dhe 22.1 të ligjit nr. 49/2012.

19. Për të gjitha sa u parashtruan më sipër, Gjykata Administrative e Apelit bazuar në nenet 16.1, 22.1 dhe 50 germa “b” të ligjit Nr. 49/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave Administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, si dhe në nenin 107 të ligjit nr. 9920/2008, vlerëson se vendimi Nr. 432, datë 14.07.2014 i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Shkodër me të cilin është proceduar me mospranimin e padisë është një vendim i drejtë i mbështetur në prova dhe në ligj pasi paditësja nuk mund të ngrëjë padi në gjykatën administrative , pa plotësuar një ndër parakushtet procedurale siç është pagesa e detyrimit tatimor, veprim ky, i cili është përcaktuar shprehimisht në ligj si kusht për marrjen në shqyrtim si të ankimit administrativ dhe atij gjyqësor.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Administrative e Apelit, në mbështetje të neneve 16.1 dhe 50 germa “b” të ligjit Nr. 49/2012 ”Për organizimin edhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”,

VENDOSI

- Lënien në fuqi të vendimit Nr. 432, datë 14.07.2014 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Shkodër.
- Kundër këtij vendimi lejohet rekurs në Kolegjin Administrativ të Gjykatës së Lartë brenda 30 ditëve , duke filluar ky afat nga dita e nesërme e njoftimit të tij.

U shpall, sot në Tiranë, më datë 03.11.2016.

**ANËTAR
ARTUR MALAJ**
D.V

**ANËTARE
BLERONA HASA**
D.V

**KRYESUESE
FJORALBA PRIFTI**
D.V

Vërtetohet njësia me origjinalin

*Rancoloria
Leonard Shkodri
Shkodra*